



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT**

Nr. 787/prot.
2

Tiranë më 5.7.2018

VENDIM

Nr. 29, datë 5.7.2018

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesja, Znj. _____ ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur "Komisioneri") Formularin e Ankesës nr. 787 Prot., datë 27.04.2018, me objekt "*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*", kundër Autoritetit Publik "Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë" (në vijim quajtur "Autoriteti Publik").

Ankuesja në cilësinë e kërkueses, me shkresën e datës 27.03.2018 ka kërkuar nga Autoriteti Publik t'i vihet në dispozicion dokumentacioni dhe informacioni i disponueshëm lidhur me:

- 1. Kopjen e të gjithë urdhrave të brendshëm të nxjerrë nga Kryetarja e Gjykatës që prej ditës së emërimit të saj deri në ditën e depozitimit të kërkesës për informim pranë Autoritetit Publik.*

Me shkresën nr. 7416/1 Prot., datë 09.05.2018 Autoriteti Publik ka kthyer përgjigje duke vënë në dispozicion të kërkueses vetëm dokumentacionin e prodhuar deri në datën e largimit të saj nga detyra, duke qenë se kjo e fundit ka qenë nëpunëse pranë autoritetit publik.

Pas refuzimit të dhënies së informacionit nga Autoriteti Publik, ankuesja pretendon se: *Dokumentacioni i kërkuar përbën informacion publik në kuptim të pikës 2, të nenit 2, të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit".*

Në këto kushte, ankuesja kërkon nga Komisioneri ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit si dhe urdhërimin e dhënies së informacionit/dokumentacionit nga autoriteti publik.

Komisioneri, në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, komunikoi me Autoritetin Publik, me qëllim verifikimin e fakteve dhe rrethanave që mund të jenë bërë pengesë për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar.

Nga shkresa nr.7416/1prot., datë 09.05.2018 rezulton se kërkuases i është vënë në dispozicion informacioni i kërkuar vetëm për periudhën nëntor 2016 (data e emërimit të Kryetares) deri në 27.12.2017 (data e largimit të Znj. Hysaj nga detyra). Nuk janë vënë në dispozicion urdhrat e nxjerrë deri më datë 27.03.2018 (data e kërkesës). Pra kërkesa për informim është përmbushur pjesërisht.

Pas kontaktit, Autoriteti Publik, me shkresën nr. 7416/4 Prot., datë 20.06.2018, ka kthyer përgjigje duke vënë në dijeni edhe Zyrën e Komisionerit se, *kërkuësja nuk ka shprehur interes të ligjshëm për marrjen e dokumentacionit dhe se nuk mund të veprojë jashtë kompetencave si një organ kontrollues i Autoritetit Publik.* Në shkresën kthim përgjigje citohet neni 79 e në vijim i ligjit nr. 96 datë 06.10.2016, “Për statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe nenin 37 i ligjit nr. 98 datë 06.10.2018, “Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, si kuadër ligjor rregullator i vlerësimit të veprimtarisë së Kryetarit të Gjykatës, aftësitë drejtuese dhe organizative si dhe aftësitë e komunikimit. Në vijim të këtij arsytimi sqarohet se *janë përfaqësuar 542 urdhra, qëllimi i të cilëve është organizimi i punës brenda institucionit. Nëpërmjet tyre mbikëqyret puna administrative si dhe bashkërendohet veprimtaria e menaxhimit të çështjeve gjyqësore. Këto urdhra dalin nga institucioni vetëm me kërkesë të institucioneve kompetente dhe të varësisë.*

Në përfundim Autoriteti Publik fton kërkuesen të konsultohet me dokumentacionin e kërkuar në ambientet e tij.

Zyra e Komisionerit konstaton se arsytimi i Autoritetit Publik lidhur me refuzimin e dhënies së informacionit të kërkuar, nuk qëndron pasi e kufizon atë me kohën gjatë së cilës kërkuësja ka punuar në këtë institucion dhe refuzon ta informojë për dokumente të prodhuar pas largimit të saj nga detyra.

Pretendimi i Autoritetit Publik se dokumentacioni i kërkuar, përfshin dokumente të prodhuara, nëpërmjet së cilave mbikëqyret puna administrative dhe bashkërendohet veprimtaria e menaxhimit të çështjeve gjyqësore dhe se këto urdhra dalin nga institucioni vetëm me kërkesë të institucioneve kompetente dhe të varësisë, nuk është i bazuar në ligj.

Autoriteti Publik ka proceduar me dhënien e një pjese të informacionit të kërkuar. Për rrjedhojë nuk mund të refuzojë vënien në dispozicion të pjesës tjetër të informacionit i cili ka po të njëjtën natyrë me informacionin e dhënë më parë. Gjithashtu, Autoriteti Publik ka ftuar kërkuesen të konsultohet me dokumentacionin e kërkuar në ambientet e tij, ç’ka nënkupton që ky dokumentacion nuk kufizohet, pasi nuk dëmton asnjë nga interesat e parashikuar në nenin 17 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Në pikën 2, të nenit 2 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", *informacion publik konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik.*

Në pikën 1, të nenit 3 parashikohet se: "*Çdo person gëzon të drejtën e njohjes me informacion publik, pa u detyruar të shpjegojë motivet*".

Gjithashtu, në pikën 3, të nenit 3 të tij, parashikohet se: "*Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit*".

E drejta e informimit, bën pjesë në grupin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të mbrojtura posaçërisht nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ). Organet e administratës publike janë të detyruara t'i nënshtrohen parashikimeve kushtetuese dhe të konventës, por dhe atyre të parashikuara në ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", me qëllim garantimin efektiv të parimit të transparencës.

Kështu, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë parashikon:

Neni 15 "1. Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhumueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik. 2. Organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre."

Neni 23 "E drejta e informimit është e garantuar. Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore."

Ndërsa në nenin 10 të KEDNJ është përcaktuar se : "*Çdo kush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë."*

E drejta për informim është një prej të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Në këto kushte, në lidhje me ankesën e Znj. ndaj Autoritetit Publik, Komisioneri vlerëson se ankesa është e bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative",

VENDOSA:

1. Pranimin e ankimit nr. 787 datë 27.04.2018 të Znj. _____, kundër Autoritetit Publik, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare".
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik për vënien në dispozicion të informacionit publik kopje të gjithë urdhrave të brendshëm të nxjerrë nga Kryetarja e Gjykatës për pjesën e refuzuar të informacionit që i takon periudhës 27.12.2017 (data e largimit të Znj. Hysaj nga detyra) deri më datë 27.03.2018 (data e kërkesës), brenda datës 12 . 7 .2018.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".
4. Ky vendim u shpall sot në datë 5 . 7 .2018.

KOMISIONERI

Besnik Deryishi

